



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 2429, datë 13.03.2014

Për

“Miratimin e dokumentit “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”” dhe publikimin e qëndrimit të AKEP mbi komentet e palëve të interesit.

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anetare
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtare

dhe sekretare Znj. Elda Topi, në mbledhjen e datës 13.03.2014, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008, i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë””, ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e dokumentit për “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”” dhe publikimin e qëndrimit të AKEP mbi komentet e palëve të interesit.

B A Z A L I G J O R E:

1. Gërma d), nj) dhe p) e nenit 8, neni 13 e vijues, neni 114 dhe 115 i ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008, “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, (**Ligji nr. 9918, i ndryshuar**);
2. Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

3. Rregullore nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”, miratuar me Vendim nr. 1774, datë 02.02.20012 të Këshillit Drejtues të AKEP, (*Rregullore nr. 24*);
4. Vendimin nr. 2402, datë 26.12.2013 për “Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””,

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt - Vendimi;
- Relacioni shoqërues i Projekt-Vendimit;
- Komentet e palëve të interesuara mbi dokumentin “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”” dhe qëndrimin e AKEP mbi komentet e palëve të interesuara;
- Akti Administrativ “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””;
- Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, si dhe duke i’u referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, me Vendimin nr. 2402, datë 26.12.2013 Për “Miratimin për Këshillim Publik të dokumentit “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””, ka publikuar projektaktin administrativ për palët e interesuara.
2. AKEP në zbatim të nenit 110, të ligjit nr. 9918, i ndryshuar, publikoi dokumentin rregullator në faqen e internetit: www.akep.al dhe caktoi periudhën për Këshillimin Publik, nga data 06.01.2014 deri më datë 20.02.2014.
3. Gjatë periudhës së këshillimit publik, sipërmarrësit kanë paraqitur komentet e tyre mbi dokumentin “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””, si më poshtë vijon:
 - Albtelecom sh.a, dërguar me shkresën me nr. 418 Prot., datë 20.02.2014 të AKEP “*Komentet e Albtelecom sh.a. mbi dokumentin për këshillim publik “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””*”;
 - Plus Communication sh.a., dërguar me shkresën nr. 434 Prot., datë 21.02.2014 të AKEP, “*Komente mbi këshillimin publik për ndryshimet në Rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm.*”

- Vodafone Albania sh.a., dërguar me shkresën nr. 463 Prot., datë 25.02.2014 të AKEP, “Komente për këshillim publik mbi rishikimin e Rregullores për Autorizimin e Përgjithshëm.
- Albanian Mobile Communication sh.a., dërguar email datë 27.02.2014, “Komentet e në lidhje me konsultimin publik për ndryshimet në rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm”.

Gjithashtu, Grupi i Punës pas periudhës së këshillimit publik ka marrë në konsideratë dhe ka bërë plotësime dhe saktësime tekstuale në akt, në mënyrë që dokumenti final të jetë një dokument cilësor dhe t’i shërbejë më së miri qëllimit të hartimit dhe nxjerrjes së tij.

Në përfundim AKEP, pasi mori në shqyrtim dhe vlerësoi komentet e paraqitura nga sipërmarrësit, publikon qëndrimin e tij mbi komentet sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Këshilli Drejtues, bazuar në pikën 1 të nenit 114, pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Miratimin e dokumentit rregullator “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregullore nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””;
2. Publikimin e qëndrimit të AKEP mbi komentet e palëve të interesuara sipas dokumentit bashkëlidhur;
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit të AKEP www.akep.al;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë me miratimin e tij, dhe efektet e dokumentit “Për disa ndryshime dhe shtesa në aktin normativ Rregullore nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm”” fillojnë në datën 01.05.2014.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. Alban **KARAPICI**
2. Alketa **MUKAVELATI**
3. Benon **PALOKA**
4. Zamira **NURÇE**



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË AKTIN NORMATIV

RREGULLORE NR. 24, DATË 02.02.2012 “PËR AUTORIZIMIN E PËRGJITHSHËM”

Miratuar me VKD Nr. 2429 datë 13.03.2014

I. Ndryshime dhe shtesa në Kreun e II-të të Rregullores “Procedurat dhe kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm”

1. Paragrafi i parë i Rregullores ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

Në mbështetje të shkronjave d), p) dhe nj) të nenit 8, nenit 13 e vijues dhe pikës 1 të nenit 114 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr.102/2012 datë 24.10.2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918.datë 19.05.2008”.

2. Pika 2 e nenit 1 “Të përgjithshme”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

2. *“Termet e përdorur në këtë Rregullore do kenë të njëjtin kuptim si në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe në rast se nuk janë të përkufizuar në ligj, do të jenë në përputhje me rekomandimet dhe vendimet përkatëse të KE dhe BEREC.*

3. Paragrafi 2 i pikës 1 të neni 2 “Fusha e zbatimit”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

1. *“Ushtrimi i aktivitetit në fushën e komunikimit elektronik për sipërmarrësit e pajisur me Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, në rastin kur ofrimi i rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike kërkon përdorimin e burimeve natyrore të fundme, bëhet pas njoftimit dhe dhënies së të drejtës së përdorimit për numeracion dhe frekuenca. Në këtë rast personi/at i/e interesuar duhet të pajiset me Autorizim Individual.”*

2. Pika 2 e nenit 2 “Fusha e zbatimit”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

“Në zbatim të rregullimeve të përcaktuara në këtë Rregullore, kushtet e përdorimit të frekuencave që përdoren pa autorizim individual dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdorin këto frekuenca, bazuar në faktin se rreziku i interferencave është minimal, janë përcaktuar nga AKEP me Rregulloren në fuqi “Mbi kushtet e përdorimit të frekuencave dhe kërkesat teknike për pajisjet radio që përdoren pa autorizim individual“- miratuar me VKD nr. 1126, datë 08.01.2010”.

4. Pika 3 e nenit 3 “Procedura e njoftimit”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

3. *“Kur informacioni për regjistrimin e një njoftimi nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj dhe në këtë rregullore AKEP brënda 7 (shtatë) ditëve nga aplikimi online, njofton të interesuarin për nevojën e plotësimit/saktësimit të informacionit. I*

interesuari duhet të paraqesë duke plotësuar online tek Moduli i Aplikimit Online për Autorizim të Përgjithshëm, Njoftimin e plotë brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të AKEP. Nëse sipërmarrësi nuk e plotëson online informacionin e munguar brenda 15 ditëve, AKEP-i informon online sipërmarrësin se nuk do ta regjistrojë atë. Sipërmarrësi ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP-it për këtë çështje”.

5. Pika 7 e nenit 3 “Procedura e njoftimit”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

7. “Nëse sipërmarrësi brenda 30 ditëve nga njoftimi i AKEP nuk tërheq Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, AKEP i lind e drejta e kryerjes së procedurës së çregjistrimit të sipërmarrësit nga regjistri i sipërmarrësve”.

6. Germa c), e pikes 2 të nenit 4 të rregullores “Çertifikata e konfirmimit të njoftimit”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

(c) “sipërmarrësi do të zbatojë Kushtet e Përgjithshme të ofrimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, të përcaktuara në Aneksin C të kësaj rregulloreje si dhe kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi ”.

7. Në nenin 4 “Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit” (Aneksi B), shtohet pika 4 me përmbajtje si më poshtë:

Pika 4 - Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit, do të përmbajë elementin **Bar Code/QR_Code**.



8. Germa h) e pikës 1, të neni 6, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

h) “data e parashikimit të fillimit/ndryshimit dhe mbylljes së aktivitetit”.

9. Pika 1 e nenit 7 “Detyrimi për dhënie Informacioni” ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

1. Sipërmarrësit që operojnë nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshme janë të detyruar të japin të dhëna/informacionin e duhur në AKEP në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr. 9918,

datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, si dhe sipas kërkesave të akteve rregullatore të miratuara nga AKEP-i. Informacioni me të dhënat e përcaktuara duhet të dërgohet në modulën e aplikimeve online.

10. Pika 2 e nenit 9 “Regjistri i sipërmarrësve”, riformulohet dhe bëhet me përmbajtje si më poshtë:

2. *“Nëse sipërmarrësit kanë njoftuar AKEP-in për mbylljen e aktivitetit dhe kanë në përdorim burime natyrore të fundme (frekuenca dhe/ose numeracion), atëherë AKEP përveç veprimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, revokon vendimin/et respektive me të cilin/ët i është/janë dhënë të drejtat mbi burimet natyrore të fundme për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.*

11. Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 9/1

Ndryshimet në të dhënat e regjistrimit ligjor

Sipërmarrësit që kanë pësuar ndryshim në të dhënat e regjistrimit ligjor janë të detyruar që të njoftojnë AKEP-in për ngjarjen e pritshme brenda 30 ditëve nga ndodhja e tyre.

Sipërmarrësi ka detyrimin të zbatojë procedurën për ndryshimet në Njoftimin e Regjistrimit sipas kesaj rregulloreje, duke dërguar bashkëngjitur në modulën e aplikimeve online dokumentet që vertetojnë ndryshimet ligjore sipas rasteve:

- a) Ndryshim i emrit të shoqërisë;*
- b) Ndryshim i formës juridike;*
- c) Ndryshime të tjera ligjore.*

12. Në nenin 10 “Pagesat” shtohet pika 2 me përmbajtjen si më poshtë:

2. *Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit i jepet sipërmarrësit pas kryerjes së pagesës të përcaktuar në këtë rregullore.*

13. Pika 1 e nenit 11 të rregullores “Publikimi”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

1. *“Kjo Rregullore, si dhe çdo ndryshim i saj miratuar me Vendim të KD të AKEP, publikohet në faqen zyrtare të AKEP”.*

II. Ndryshime dhe shtesa në Aneksin A “Njoftim regjistrimi për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike”, të Rregullores nr. 24.

1. Në dosjen e përshkrimit për rrjetet dhe shërbimet, në dokumentet që dërgon bashkëngjitur personi juridik/fizik, pika d) ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

“Përshkrimi teknik për rrjetet dhe/ose shërbimet që kërkon të ofrojë dhe masat e marra për mbrojtjen dhe sigurinë e tyre.”

Në pjesën A “Rrjete publike të komunikimeve elektronike”, pika 1. Rrjete publike tokësore fikse, pika 1.4 “Llojet e shërbimeve ofrimi i të cilave është lejuar nga mënyra e ndërtimit të rrjetit”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

1.4 Llojet e shërbimeve	<input type="checkbox"/> Telefoni fikse
	<input type="checkbox"/> Akses Interneti
	<input type="checkbox"/> Programe audiovizive
	<input type="checkbox"/> Transmetim të dhënash
	<input type="checkbox"/> Linja me qera
	<input type="checkbox"/> Shërbime të tjera (specifikoji)

2. Në pjesën 2 “Shërbimet e linjave me qira”, specifikimi i linjave për pikën 2.1.1 dhe 2.1.2 ndryshon dhe bëhet:

<input type="checkbox"/> Llojet e linjave me qira	2.1.1. <input type="checkbox"/> Analog	
	2.1.2. <input type="checkbox"/> Dixhital	<input type="checkbox"/> n x 64 Kbit/s <input type="checkbox"/> 2048 Kbit/s <input type="checkbox"/> >2048 Kbit/s <input type="checkbox"/> Ethernet <input type="checkbox"/> xDSL <input type="checkbox"/> Lloje të tjera (specifikoji)

3. Në faqen e fundit të Aneksit A, titulli (togfjalëshi) “Paraqitja e detyrimeve ligjore”, zëvendësohet me togfjalëshin:

“Deklarim i Personit (Juridik/Fizik)”

III. Ndryshime dhe shtesa në Aneksin C të Rregullores nr.24, dt. 02.02.2012 mbi “Kushtet e përgjithshme të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike në regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm”

1. Fjalja e fundit e pikës 1 të Aneksit C “Pajisja me autorizime”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

“Njoftimit për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike.”

2. Pika 3 e Aneksit C “Përdorimi i frekuencave”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

“Në rast se sipërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike do të përdorë frekuenca, atëherë së bashku me njoftimin për regjistrim duhet të aplikojë edhe për pajisjen me Autorizim Individual për përdorimin e frekuencave.

Dhënia për përdorim e frekuencave bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Përcaktimet e Planit Kombëtar të Frekuencave, Planit të Përdorimit të Frekuencave, Rregullores Nr.30, datë 05.12.2013 “Për dhënien e Autorizimit Individual për përdorimin e frekuencave”, në bazë të parimit të objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit e mosdiskriminimit, duke respektuar marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është palë dhe radorregulloret e ITU-së.

AKEP, rezervon të drejtën të inspektojë në çdo kohë stacionet apo një lidhjeje radio, për tu siguruar se sistemi është konfiguruar dhe operon në përputhje me kushtet e Autorizimit Individual”.

3. Në piken 9 në Aneksin C të rregullores “Detyrime lidhur me ofrimin e rrjeteve dhe/ose ofrimin e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike”, gërma e) e pikës 9.1 të Aneksit C, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

e) “Lejimin e përgjimit nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për përgjimin e komunikimeve elektronike dhe zbatimin e detyrimeve, që burojnë nga ky legjislacion”.

Pas gërmës i) të pikës 9.1 të Aneksit C, shtohen gërmat j); k); l) dhe m) me përmbajtjen si më poshtë:

j) Transparencë dhe informim për kufizimet e aksesit ose të përdorimit të shërbimeve ndërmjet pikave fundore të rrjetit , aplikimeve në rastin e zbatimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

k) Lejimin e autoriteteve publike për përdorimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimit, për të paralajmëruar publikun për kërcënimet e pashmangshme nga katastrofat e mëdha dhe për zbutjen e pasojave nga katastrofat e mëdha.

l) Marrjen e masave për respektimin e kufizimeve në lidhje me përmbajtjet e paligjshme ose të dëmshme sipas rregullimeve përkatëse ligjore në fuqi.

m) Ruajtjen dhe administrimin e të dhënave të pajtimtarëve të tyre për qëllime të ndjekjes penale sipas përcaktimeve të nenit 101 të ligjit nr. 9918 i ndryshuar dhe ligjit nr. 9887 date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e te dhenave personale” i ndryshuar.

4. Në gërmën a) të pikës 9.1 të Aneksit C hiqet fjalia e fundit: “Në mënyrë të veçantë, çdo sipërmarrës”.
5. Pas pikes 9.2 te Aneksit C, shtohet pika 9.3 me përmbajtjen si më poshtë:

9.3 Mbrojtja dhe siguria e rrjeteve dhe shërbimeve.

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike janë të detyruar që, individualisht ose kur është e nevojshme, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, të zbatojnë masa teknike dhe organizative, për të realizuar sigurinë e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve, të ofruara prej tyre sipas përcaktimeve të nenit 122 të ligjit 9918 dhe rregullave të nxjerra nga AKEP-i.

6. Pas pikës 9.3 të Aneksit C të shtohet pika 9.4 dhe pika 9.5 me përmbajtjen si më poshtë:

9.4 Sipërmarrësit e regjistruar në AKEP për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të kenë faqen WEB.

9.5 Sipërmarrësit në faqen e tyre web duhet të publikojnë:

- a) Infrastrukturon dhe shtrirjen e detajuar të rrjeteve fikse;**
- b) Zonën e ofrimit të shërbimeve;**
- c) Një instrument matje të shpejtësisë të aksesit në Internet për pajtimtarët i cili duhet të ofrojë mundësinë për të matur: ⁽¹⁾**

1. download speed (shpejtësinë e shkarkimit) në Mbps ose Kbps;

2. upload speed (shpejtesinë e ngarkimit) në Mbps ose Kbps.

¹ Ky kusht është detyrim vetëm për sipërmarrësit që kanë njoftuar ofrimin e shërbimit Akses në Internet

7. Pika 10 e Aneksit C “Shërbimi universal”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

Një sipërmarrës i autorizuar, për të ofruar rrjete ose shërbime të komunikimeve elektronike për publikun, ka të drejtë të marrë pjesë në përcaktimin si ofrues i shërbimit universal për shërbime të veçanta në skemën e shërbimit universal ose në pjesë të caktuara të territorit të Republikës së Shqipërisë si dhe të zbatojë të gjitha detyrimet që mund të vendosen lidhur me ofrimin e shërbimit universal, në zbatim të përcaktimeve të vendimeve të AKEP dhe akteve normative në fuqi.

8. Germa a) e pikës 16 të Aneksit C “Pajisjet fundore të telekomunikacionit dhe pajisjet radio”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë dhe në germën b) të pikës 16 të Aneksit C, në fund të fjalisë “VKM nr. 331”, ndryshohet me **“VKM nr. 546, datë 13.06.2013”**.

a) *“Gjithë pajisjet fundore të telekomunikacionit dhe pajisjet radio që përdoren nga një sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të jenë në përputhje me aktet ligjore dhe dispozitat e rregulloreve për këto lloj pajisjesh, që nxirren në përputhje dhe në zbatim të VKM nr. 546, datë 13.6.2013 “Për miratimin e rregullit teknik “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e ndërsjellë të vlerësimit të konformitetit të tyre”, si dhe Rregullores nr. 25, dt. 14.06.2012 “Për pajisjet radio fundore të telekomunikacionit dhe njohjen e konformitetit të tyre”.*

b) *“..... ne “VKM nr. 546, datë 13.06.2013.”*

9. Germa a) e pikës 17 në Aneksin C “Cilësia e shërbimeve të ofruara për përdoruesit”, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

a) *“Sipërmarrësit që ofrojnë rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike janë të detyruar të plotësojnë të gjitha detyrimet lidhur me cilësinë e shërbimeve, në përputhje me ligjin nr. 9918, i ndryshuar dhe Rregullore nr. 16, datë 16.04.2010 “Për treguesit e cilësisë së shërbimit”.*

10. Pika 19 e Aneksit C, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë si dhe germa c) e pikës 19 korrigjohet dhe bëhet germa b):

Pika 19. Mbrojtja e përdoruesit.

a) Cilido sipërmarrës që ofron rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të zbatojë detyrimet ligjore dhe rregulloreve lidhur me mbrojtjen e **përdoruesve**. Çdo marrëveshje që sjell kufizime apo eliminim të përgjegjësive të sipërmarrësit në këtë drejtim konsiderohet e pavlefshme.

b) Sipërmarrësit janë të detyruar të aplikojnë procedura për shqyrtim të menjëhershëm të kërkesave dhe ankesave të bëra nga pajtimtarët/përdoruesit lidhur **me kushtet kontraktore dhe/ose përmbushjen e këtyre kushteve nga operatori, përfshirë faturën dhe cilësinë e shërbimit të ofruar. Mënyra dhe procedura për ankesat e pajtimtarëve përcaktohen në nenin 107 të ligjit 9918 dhe kushtet e kontratës të pajtimtarit. Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis palëve, përcaktohen në Rregulloren nr.29, datë 29.05.2013 “Per zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet pajtimtarëve dhe sipërmarrësve të komunikimeve elektronike”.**

11. Pika 20.2 e Aneksit C, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

Një kontratë e lidhur ndërmjet një pajtimtari dhe një sipërmarrësi që ofron lidhjen dhe/ose aksesin në rrjetin publik telefonik ose ndërmjet një **përdoruesi** dhe një ofruesi shërbimesh të komunikimeve elektronike **hartohet sipas përcaktimeve të nenit 99 të ligjit 9918 dhe akteve të tjera rregullatore dhe individuale të nxjerra nga AKEP-i.**

12. Pika 20.3 e Aneksit C, ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

*"Kontrata e pajtimit ndërmjet sipërmarrësit dhe pajtimtarit, hartohet nga sipërmarrësit mbi bazën e legjislacionit në fuqi dhe rregullave të nxjerra nga AKEP-i në zbatim të ligjit nr.9918 i ndryshuar. **Sipërmarrësi depoziton në AKEP një kontratë Tip me terma standarte, për vlerësim 15 ditë para hyrjes në fuqi të saj, dhe në cdo rast të ndryshimeve eventuale të këtyre termave".***

13. Pika 23.3 e Aneksit C “Numeratori telefonik dhe shërbimet e informacionit” ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

*Ofruesit e Shërbimit Publik Telefonik janë të detyruar të zbatojnë **përcaktimet e ligjit nr.9918 dhe kuadrin rregullator për numeratorin telefonik dhe shërbimet e informacionit, sipas përcaktimeve të AKEP në aktet përkatëse.***

14. Pika 23.5 ndryshohet dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

Pika 23.5 Fatura e pajtimtarit

23.5.1 Mbrojtja nga mbifaturimi i pajtimtarit në Rrjetin e Komunikimeve Publike Elektronike.

a) **Për të mbrojtur përdoruesit e shërbimeve të tyre, sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të marrin parasysh maksimalisht si më poshtë:**

- i) sipërmarrësit duhet të kontrollojnë sjelljen e zakonshme të përdoruesve gjatë përdorimit të shërbimit, dhe t'i njoftojnë ata për ndonjë rritje të pazakontë, te paarsyeshme dhe të papritur të shpenzimeve për shërbime të veçanta, të cilat mund të tregojnë abuzim ose përdorim të paautorizuar.
- ii) sipërmarrësi mund të ndërpresë përdorimin e shërbimit të veçantë pasi të ketë paralajmëruar pajtimtarin për veprimin që do të marrë;
- iii) pajtimtari i Aksesit në Internet duhet veçanërisht të njoftohet me mjete elektronike (si p.sh. SMS, mesazh në PC, telefon) kur arrihet niveli 80% i kufizimit “download”/’upload” (nëse ka të tillë). Sipërmarrësi mund të kufizojë shpejtësinë e Aksesit në Internet pas kalimit të kufizimit download/upload, për të reduktuar mundësinë e shpenzimeve shumë të larta për pajtimtarin pas tejkalimit të kuotës/limitit.
- b) Sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, kur kërkohet me kërkesën e pajtimtarit, t'i paraqesin atij faturën e detajuar për shërbimet e ofruara (këtu e më poshtë: faturë) pa pagesë, dhe veçanërisht si më poshtë:
- i) fatura për çdo thirrje dhe mesazh të shkruar do të përfshijë datën dhe kohën e lidhjes fillestare, numrat e thirrur, kohëzgjatjen e thirrjes, madhësinë e të dhënave të transmetuara dhe kritere të tjera për llogaritjen e shërbimit;
- ii) të dhëna për thirrjet për shërbimet me vlerë të shtuar, të cilat përmbajnë të dhëna për ofrimin e shërbimeve me vlerë të shtuar dhe, kur janë të aplikueshme, të dhëna për llojin e shërbimit;
- iii) shërbimet pa pagesë si telefonatat falas (0800) dhe thirrjet drejt numrave të emergjencës nuk do të regjistrohen në faturë, përveç se në rastet kur kërkohet nga pajtimtari faturë më e detajuar, rast pas rasti.
- c) Sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet t'u lejojnë pajtimtarëve të tyre, që me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, të bllokojnë kryerjen e thirrjeve dalëse kur shpenzimet mujore të këtyre thirrjeve tejkalojnë një nivel të paracaktuar, dhe bllokimin e kryerjes së thirrjeve drejt kategorive të caktuara numrash, dhe veçanërisht si më poshtë:
- i) mundësia e bllokimit të thirrjeve dalëse i referohet ekskluzivisht thirrjeve që janë me pagesë si, drejt numrave të shërbimeve me vlerë të shtuar, thirrje ndërkombëtare, roaming ndërkombëtar, dhe sipërmarrësit duhet të krijojnë mundësinë kryerjes së thirrjeve drejt numrave të emergjencës dhe telefonat pa pagesë të shërbimeve të kujdesit për klientin të operatorit;
- ii) pajtimtarët që kanë kërkuar bllokimin e thirrjeve dalëse kur shpenzimet e tyre mujore kanë tejkalluar nivelin e paracaktuar kanë të drejtë të marrin informacion rreth

konsumit të tyre në çdo kohë dhe në mënyrë të thjeshtë, dhe duhet të informohen nëse përdorimi i shërbimit gjatë një muaji i afrohet madhësisë së paracaktuar për këtë;

iii) operatorët duhet që periodikisht (të paktën një herë në vit) të informojnë me shkrim (si komunikim me SMS, e-mail, përfshirje në faturën e një muaji) gjithë pajtimtarët mbi të gjitha mundësitë e bllokimit të thirrjeve të disponueshme për ta, dhe veçanërisht rreth mundësive referuar këtij Neni.

d) Sipërmarrësit e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të lejojnë pajtimtarët, pa vonesë dhe me kërkesën e tyre, bllokimin në mënyrë të thjeshtë, të plotë dhe pa pagesë të disa lloje thirrjesh dalëse ose thirrjet drejt disa numrave ose grup numrash.

23.5.2 Formati dhe Përmbajtja e Faturës së Pajtimtarit

a) Përmbajtja e faturës së pajtimtarit duhet të jetë e qartë, lehtësisht e kuptueshme dhe e lexueshme.

b) Me kërkesë të pajtimtarit, përmbajtja e faturës mund të jetë e disponueshme dhe në mënyrë alternative për të plotësuar nevojat e njerëzve me probleme shikimi.

c) Çdo faturë e pajtimtarit do të përfshijë në mënyrë të qartë afatin e pagesës së faturës, si edhe metodat e pranueshme të pagesës, afatet kohorë për ankesat si edhe detajet e kontaktimit të shërbimit të kujdesit për klientin.

d) Fatura e printuar duhet të jetë e disponueshme për të gjithë pajtimtarët. Faturat elektronike në përputhje me rregullat e veçanta (të ndara ose së bashku me faturën e printuar) mundet gjithashtu të ofrohet si një opsion.

15. Pika 23.6 e Aneksit C “Tarifat” . (Çfuqizohet)

16. Në pikën 23.8 “Transparenca dhe publikimi i informacionit”, ndryshon dhe bëhet me përmbajtjen si më poshtë:

Sipërmarrësit e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun duhet të publikojnë informacion transparent, të krahasueshëm, të përshtatshëm dhe të përditësuar për tarifat dhe çmimet e aplikuara, për përdoruesit fundorë, në përputhje me nenin 98 të ligjit 9918, i ndryshuar dhe kërkesave që parashtohen në Rregulloren nr. 27, datë 21.09.2012 “Mbi Publikimin e informacionit për tarifat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike” .

Ky informacion duhet të publikohet në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirës dhe lehtësisht të aksesueshëm.

17. Në pikën 24 të Aneksit C “Portabiliteti i numrave” të shtohet fjala “***e ndryshuar***” pas togfjalëshit “Rregullores së portabilitetit”.

18. Pika 26.1 “Ofrimi i Telefonisë fikse nga ofruesit virtualë hiqet me arsyetimin”:

“ Si rezultat i mungesës së interesimit nga palët për të ofruar shërbime virtuale dhe në mungesë të një parashikimi eksplicit ligjor të ligjit nr.9918, propozojmë që percaktimi i të drejtës në pikën 26.1 të hiqet”.

19. Në pikën 27 “Detyrime lidhur me vendosjen e telefonave publikë”, pas gërmës g), shtohet fjalia me përmbajtjen si më poshtë:

“Sipërmarrësit që ofrojnë shërbime publike të komunikimeve elektronike duhet të sigurojnë akses për përdoruesit me aftësi të kufizuar, duke bërë lehtësisht të disponueshëm përfitimin e shërbimeve të tyre nga këta të fundi, si dhe të informojnë këtë kategori përdoruesish për detajet e produkteve dhe shërbimeve të projektuara për ata.”

Në pikën 27 të Aneksit C, tek paragrafi i tretë shtohet togfjalëshi “... dhe pa mjet pagese” dhe tek paragrafi fundit togfjalëshi:

***“që përdorin karrike me rrota”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:
“aftësi të kufizuara”.***

20. Pika 32 “Pagesat” të numerohet si pika 33 dhe pika 32 formulohet me përmbajtjen si më poshtë:

Regjistrimi i sipërmarrësve për rrjetet që transmetojnë “Programe audiovizive”.

a) AKEP, sipas përcaktimeve të nenit 3 të ligjit nr.9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 138 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", do të regjistrojë sipas procedurës të njoftimit të përcaktuar në këtë rregullore, sipërmarrësit që dëshirojnë të ofrojnë rrjete të komunikimeve elektronike që mundesojnë transmetimin e “Programeve audiovizive”.

b) AKEP, për sipërmarrësit e përmëndur në gërmën a) më sipër, të cilët ofrojnë shërbimet e transmetimit të programeve audiovizive bazuar në ligjin nr.97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë, do të bëjë regjistrimin në një regjistër të veçantë vetëm për rrjetin e komunikimeve elektronike për të cilin kanë detyrimin ligjor për të njoftuar në AKEP.

21. Në pikën 32 të Aneksit C “Pagesat”, në paragrafin e parë:
“.....VKM nr. 599, dt 23.07.2010”, ndryshohet dhe bëhet:

“.....VKM nr. 911, dt. 19.12.2012”

22. Në piken 33 “Pagesat”, pjesa “Pagesat që kryhen në AKEP” të numerohet si pika 33.1 dhe të shtohet pika 33.2 me përmbajtjen si më poshtë:

33.2 Pagesat për kostot administrative të aplikimeve online.

Sipërmarrësit që aplikojne në modulin e aplikimeve online, njoftim për regjistrim të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, duhet të kryejnë në AKEP pagesën për kostot administrative për realizimin e këtij procesi, sipas rasteve:

- a) *Sipërmarrësit të cilët aplikojnë online për herë të parë, duke dërguar njoftimin e regjistrimit të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, për të cilët AKEP lëshon Çertifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, duhet të kryejnë pagesën në vlerën 10.000 lekë. Kjo pagesë kryhet vetëm një herë.*
- b) *Sipërmarrësit e regjistruar në AKEP, të cilët dërgojnë njoftim për ndryshimin e të dhënave ligjore dhe shtim ose heqje të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, ndryshime për të cilat AKEP lëshon Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, duhet të kryejnë për çdo rast pagesën në vlerën 5.000 lekë.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

ÇERTIFIKATË
E KONFIRMIMIT TË NJOFTIMIT

Nr. ____ /datë ____ . ____ . ____

SIPËRMARRËSI “XXXXXXXXXX”

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare konfirmon se sipërmarrësi “XXXXXXXXXX” me adresë: XXXXXX, ka paraqitur Njoftimin e Regjistrimit sipas Nenit 14 të Ligjit Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i **ndryshuar** dhe është regjistruar në Regjistrin e Siperarrësve për ofrimin e rrjeteve dhe të shërbimeve publike te komunikimeve elektronike sipas Regjimit të Autorizimit të Përgjithshëm:

K R Y E T A R I

(nënshkrimi & vula e autoritetit)

**Rrjete dhe shërbime publike të komunikimeve elektronike
të njoftuara në AKEP nga sipërmarrësi “XXXXXXXXX”**

A. Rrjete publike të komunikimeve elektronike:

a)
.....

B. Shërbime publike të komunikimeve elektronike:

b)
.....

Sipërmarrësi i regjistruar për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të mësipërme, i cili operon nën regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm, është i detyruar të zbatojë termat dhe kushtet e parashtruara në Aneksin C të Rregullores së Autorizimit të Përgjithshëm.

Në faqen e internetit AKEP publikon një regjistër të përditësuar i të gjithë sipërmarrësve të cilët kanë njoftuar ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke përfshirë informacionin mbi llojet e rrjeteve dhe shërbimeve që ata ofrojnë.

Nr. 20XX-AP-U__X-X / datë XX.XX.20XX



Bar Code/QR_Code



AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

KOMENTET E PALEVE TE INTERESUARA DHE QËNDRIMI I AKEP MBI KOMENTET

**Në lidhje me dokumentin për këshillim publik
“Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren nr.24, datë 02.02.2012
“Për Autorizimin e Përgjithshëm”**

Tiranë 13.03.2014

A. HYRJE

Këshilli Drejtues i AKEP me Vendimin nr. 2402, datë 26.12.2013 vendosi të miratojë për Këshillim Publik aktin administrativ “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””.

Konsultimi publik u krye në periudhën 06.01.2014 deri 20.02.2014. Në përfundim të periudhës së konsultimit, komente u dërguan nga palët e interesuara: Albtelecom sh.a., Vodafone Albania sh.a., AMC sh.a dhe Plus Communication sh.a.

AKEP, dëshiron të falënderojë palët e interesuara për kontributin e tyre me komentet dhe sugjerimet e dhëna për propozimet e AKEP në lidhje me aktin administrativ “Për disa ndryshime dhe shtesa në Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””.

Ky dokument përmban komentet e sipërmarrësve dhe qëndrimet e AKEP për komentet. Qëndrimi i AKEP për komentet është reflektuar në hartimin e ndryshimeve përfundimtare në aktin administrativ “Për disa shtesa dhe ndryshime në Rregulloren nr. 24, datë 02.02.2012 “Për Autorizimin e Përgjithshëm””.

B. KOMENTET E SIPËRMARRËSVE DHE QËNDRIMI I AKEP.

I – Komente mbi ndryshime dhe shtesa të propozuara në Rregulloren nr.24, dt. 02.02.2012

“Procedurat dhe kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm”.

1. Komente mbi pikën 3 e nenit 3 “Procedura e njoftimit”.

1.1 - Albanian Mobile Communication sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

AMC është e mendimit që afati 30 ditë nga data e njoftimit në AKEP për plotësimin e informacionit për Autorizim të Përgjithshëm, në rastim kur AKEP e ka vlerësuar “Kthim për rishikim” të mos ndryshojë, duke lënë në fuqi këtë afat siç është parashikuar në Rregulloren Nr.24, dt.02.02.2012, dhe duke hequr pjesën e re të shtuar si më poshte:

“Nëse sipërmarrësi nuk e plotëson online informacionin e munguar brenda 15 ditëve, AKEP-i informon online sipërmarrësin se nuk do ta regjistrojë atë. Sipërmarrësi ka të drejtë të ankohet në Këshillin Drejtues të AKEP-it për këtë çështje”.

1.2 - Qëndrimi i AKEP.

AKEP sqaron se formulimi i pikës 3 të nenit 3 “Procedura e njoftimit” është në përputhje të plotë me përcaktimet e pikës 6 të nenit 4 të ligjit nr.9918 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

2. Komente mbi nenin shtesë 9/1 “Mbi të dhënat e regjistrimit ligjor”

2.1 - Albtelecom sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

Sipas propozimit të AKEP, ku në fjaline e parë të nenit9/1 është shprehur se *“Sipërmarrësit që kanë pësuar ndryshim në të dhënat e regjistrimit ligjor janë të detyruar që të njoftojnë AKEP-in për ngjarjen e pritshme brenda 30 diteve para ndodhjes”*, sugjeron që kjo pikë të riformulohet si më poshte:

“Sipërmarrësit që kanë pësuar ndryshim në të dhënat e regjistrimit ligjor janë të detyruar që të njoftojnë AKEP-in pas vendim marrjes nga shoqeria dhe brenda 30 diteve nga regjistrimi i ndryshimeve në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Kjo kërkohet nga Albtelecom sh.a., për arsye se ndryshimet të një natyre të tille janë subjekt i miratimit nga organet drejtuese të shoqërisë (Asambleja e Aksionereve / Keshilli Mbikqytes) si dhe duhet të regjistrohen më parë në QKR dhe pastaj të njoftojnë për ndryshimet ligjore.

2.2 - Plus Telecommunication sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

Plus Telecommunication sh.a. është i mendimit që neni 9/1 *“Ndryshimet në të dhënat e regjistrimit ligjor”*, të riformulohet, meqenëse ka një moskohërencë në vetë tekstin e tij.

Nga njëra ana përcaktohet se *“Sipërmarrësi që ka **pësuar ndryshim** në të dhënat e regjistrimit”*, dhe nga ana tjetër njoftimi i duhet bërë AKEP për **ngjarjen e pritshme brenda 30 ditëve para ndodhjes**.

2.3 - Vodafone Albania sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

Vodafone Albania sh.a. kërkon nga AKEP që në Nenin 9/1 të shtuar në Rregullore të parashikohet njoftimi i ndryshimeve të mundshme në të dhënat e regjistrimit ligjor brenda 30 ditëve nga ndodhja e ndryshimeve dhe jo përpara ndodhjes së tyre. Përndryshe, propozimi bie ndesh me dispoziten 14/4 të ligjit 9918/2008 (ku parashikohet brenda 30 ditëve nga ngjarja).

2.4 - Qëndrimi i AKEP:

AKEP, duke marrë në konsideratë komentet e dhëna nga sipërmarrësit për riformulimin e fjalisë së parë të nenit 9/1, gjykon që neni 9/1 të ndryshojë me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 9/1 - Ndryshimet në të dhënat e regjistrimit ligjor.

Sipërmarrësit që kanë pësuar ndryshim në të dhënat e regjistrimit ligjor janë të detyruar që të njoftojnë AKEP-in brënda 30 ditëve nga ndodhja e tyre.

Sipërmarrësi ka detyrimin të zbatojë procedurën për ndryshimet në Njoftimin e Regjistrimit sipas kesaj rregulloreje, duke dërguar bashkëngjitur në modulën e aplikimeve online dokumentet që vertetojnë ndryshimet ligjore sipas rasteve:

- a) Ndryshim i emrit të shoqërisë;*
- b) Ndryshim i formës juridike;*
- c) Ndryshime të tjera ligjore.*

II – Komente mbi ndryshime dhe shtesa të propozuara në Aneksin C të Rregullores nr.24, dt. 02.02.2012 mbi “Kushtet e përgjithshme të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike në regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm”.

1. Komente mbi pikën 1 të Aneksit C “Pajisja me autorizime”.

1.1 - Albanian Mobile Communication sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

Në pikën 1 të Aneksit C “Pajisja me autorizime” fjalia e fundit ka ndryshuar me përmbajtjen si më poshtë: “Njoftimit për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.

AMC është e mendimit se kjo fjali nuk duhet të ndryshoje. Ajo duhet të ngelet ashtu sic ishte sepse edhe numeracioni është një burim i fundëm.

1.2 - Qëndrimi i AKEP

AKEP, sqaron se formulimi i pikës 1 të Aneksit C është bërë sipas përcaktimeve në Shtojcën 2 “Njoftim për caktimin dhe përdorimin e numeracionit” të Rregullores nr.10, datë 11.08.2009 “Për caktimin dhe përdorimin e numrave dhe serive numerike”.

2. Komente mbi pikën 5 të Aneksit C “Caktimi i kodeve të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC).

2.1 - Albanian Mobile Communication sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

AMC në pikën 5 të Aneksit C “Caktimi i kodeve të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC), AKEP ka propozuar të hiqet paragrafi i fundit si më poshtë cituar:

Sipërmarrësit e pajisur nga AKEP-i me NSPC dhe ISPC, duhet:

Të përdorin kodet e caktuar nga AKEP në përputhje me kushtet e vendosura në vendimet përkatëse të AKEP-it, Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”, dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje.

AMC shprehet se është kategorikisht kundër këtij propozimi. Sipërmarrësit e pajisur nga AKEP me NSPC dhe ISPC duhet ti përdorin keto kode në përputhje me kushtet e vendosura në vendimet përkatëse të AKEP dhe Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”, dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje. Sepse ndryshe i jepet një liri e pakufizuar sipërmarrësve të cilët mund të përdorin për qëllime nga me të ndryshmet, duke krijuar probleme në treg. Jo vetëm këto kode por çdo frekuencë, çdo numeracion apo çdo leje që është marrë në AKEP duhet të përdoren për qëllimin që ju është dhënë leja dhe konform vendimeve dhe rregullave të AKEP për çështjet përkatëse.

AMC, në lidhje me komentimin e mësipërm kërkon që ky paragraf të mos hiqet nga rregullorja.

2.2 - Qëndrimi i AKEP:

AKEP sqaron se ka vendosur heqjen e paragrafit të fundit të pikës 5 të Aneksit C për të mos patur përsëritje me formulimet në dy paragrafet e parë të pikës 5, në të cilët është shprehur se **caktimi i kodeve NSPC dhe ISPC** do të bëhet sipas kërkesave të Rregullores nr. 17, date 16.04.2010 “Rregullat për administrimin e kodeve të pikave të sinjalizimit kombëtar (NSPC) dhe ndërkombëtar (ISPC) për interkoneksionin e rrjeteve”.

Me gjithë atë AKEP, duke marrë në konsideratë komentimin e bërë nga AMC gjykon që të mos hiqet nga pika 5 e Aneksit C paragrafi i fundit, në të cilin është kërkuar se sipërmarrësit **duhet të përdorin kodet NSPC dhe ISPC** në përputhje me vendimet dhe rregullat e administrimit të këtyre kodeve.

3. Komente për pikën 19 “Mbrotjtja e përdoruesit” dhe pikën 20/2.

3.1 Vodafone Albania sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

Në pikën 19 të Aneksit C VA propozon që termi “përdorues” të zëvendësohet me termin “pajtimtar”, pasi vetëm ky i fundit është subjekti ligjor (individ, person fizik ose juridik) i cili

lidh marrëdhënie kontraktore me sipërmarrësin për ofrimin e rrjeteve dhe shërbimeve dhe është mbajtes ekskluziv i të drejtave dhe detyrimeve.

Këto ndyshime duhen parashikuar në:

- titullin e dispozitës 19 (Mbrojtja e **pajtimtarit**)
- pikën a) “... lidhur me mbrojtjen e **pajtimtarëve**”
- pikën b) “...dhe ankesave të bëra nga **pajtimtarët** (vazhdon fjalia)”
- pikën 20/2) “...aksesin në rrjetin publik telefonik ose ndërmjet një **pajtimtari** dhe një ofruesi shërbimesh”.

3.2 Qendrimi i AKEP - Mbi komentet për pikat 19 dhe 20/2.

Për propozimin që në pikat 19 dhe 20/2 të ndryshohet termi “përdorues” me termin “pajtimtar”, AKEP vlerëson se duke ndryshuar këtë term, kufizohet mbrojtja e përdoruesve vetëm për pajtimtarët, apo përdoruesit e kontraktuar, kur detyrimi i sipërmarrësve është për të gjithë përdoruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike.

4. Komete mbi pikën 23.5 “Fatura e pajtimtarit” kryesisht për nënpikat e mëposhtme:

- **Komete për pikën 23.5.1 “Mbrojtja ndaj Abuzimit dhe Mashtrimit në Rrjetin e Komunikimeve Publike Elektronike”.**
- **Komete për pikën 23.5.2 “Formati dhe përmbajtja e faturës së pajtimtarit”.**

4.1- Albtelcom sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

Në pikën 23.5 të Aneksit C **Fatura e Pajtimtarit**, AKEP ka propozuar vendosjen e detyrimeve shtesë në pikën 23.5.1 **Mbrojtja ndaj abuzimit dhe mashtrimit në rrjetin e komunikimeve publike elektronike** si edhe pikën 23.5.2 **Formati dhe përmbajtja e faturës së pajtimtarit**.

Albtelcom gjykon se në përcaktimin e këtyre detyrimeve shtesë duhet të ketë një arsytim të tillë mbështetës që të justifikojë natyrën detyruese të këtyre rregullave apo përcaktimeve si dhe në të njëjtën kohë përcaktimi i këtyre detyrimeve shtesë duhet të jetë në zbatim të detyrimeve kryesore që ka përcaktuar legjisllacioni në fuqi që rregullon marrëdhëniet me pajtimtarin në lidhje me faturën apo mbrojtjen që i ofrohet pajtimtarit ndaj abuzimit dhe mashtrimit në përfitimn e shërbimeve të tij.

Konkretisht, detyrimet e kësaj natyre rregullohen në Nenin 106 **Faturimi** dhe Nenin 109 **Ndërprerjet e shërbimit për pajtimtarin** të Ligjit Nr.9918, i ndryshuar.

Me ligjin Nr. 102/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 9918”, nenet e mësipërme janë amenduar në funksion të një mbrojtje më të mirë të përdoruesve, për sa i përket përmbajtjes dhe formatit të faturës si edhe mbrojtjen e pajtimtarit ndaj abuzimit dhe mashtrimit. Këto ndryshime janë në përputhje me kuadrin rregullator të BE 2002 dhe përbëjnë legjislacionin bazë në zbatim të të cilit sipërmarrësit dhe pajtimtarët përcaktojnë qartë dhe me detaje kushtet e kontratës, nënshkruar mes tyre.

Albtelecom gjykon se propozimi i AKEP për vendosjen e detyrimeve shtesë në lidhje me Faturën e Pajtimtarit, tejkalon detyrimet e mësipërme të përcaktuara në ligj në lidhje me faturën e pajtimtarit dhe nuk shohim të arsyeshme të shtohen këto detyrime në Rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm. Ndërsa në lidhje me përcaktimet dhe vendosjen e një sërë detyrimesh që lidhen me mbrojtjen e pajtimtarit nga abuzimi apo mashtrimi, Albtelecom gjykon se të gjitha këto përbëjnë lehtësira dhe fasilite që mundësohen nga zhvillimi i teknologjisë dhe përmirësimi i sistemeve të sipërmarrësit dhe janë në interes të vet operatorit në kuadër të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore për t’i aplikuar apo implementuar ato në marrëdhënien me pajtimtarin, kështu që këto rregulla duhet të mbeten në diskrecion të operatorit për tu vendosur dhe aplikuar.

Gjithashtu, këto facilitete, jo të gjitha janë teknikisht të mundura për t’u realizuar nga operatori si për shembull, përcaktimi i dhënë në gërmën c) të pikës 23.5.1 ku shprehet: “.....**bllokimin e kryerjes së llojeve të caktuara të thirrjeve dalëse, ose drejt llojeve të caktuara të numrave ose grup numrash**”; është teknikisht i pamundur për t’u realizuar, pasi bllokimi i thirrjeve dalëse për rrjetet publike të komunikimeve elektronike bëhet vetëm kundrejt destinacioneve të caktuara dhe është i pamundur të realizohet drejt llojeve të caktuara të numrave apo grup numrave të caktuar.

Në këtë këndvështrim, Albtelecom sheh të tepërt përcaktimin e këtyre rregullave në formë detyruese në Rregulloren për Autorizimin e Përgjithshëm ndërkohë që vetë sipërmarrësit aplikojnë tashmë një sërë mekanizmash dhe procedurash në ndihmë të pajtimtarit për të qenë të mbrojtur nga abuzimi e mashtrimet në përfitimet e shërbimeve nga ana e tyre. Po ashtu, vetë parashimet aktuale në kontratën e pajtimtarit parashikojnë rregulla të një natyre të tillë të cilat i mundësojnë pajtimtarit lehtësirat dhe fasilitetet e duhura në lidhje me faturën e detajuar si dhe mbrojtjen nga mashtrimet dhe abuzimet.

4.2 - Plus Communication sh.a.

Në komentet e tij parashtrohet si më poshtë vijon:

Në pikën 23.5.1 shkronja a)(i) e Aneksit C, është parashikuar se: “*Sipërmarrësit duhet të kontrollojnë sjelljen e zakonshme të përdoruesve gjatë përdorimit të shërbimit, dhe t’i njoftojnë ata për ndonjë rritje të pazakontë dhe të papritur të shpenzimeve për shërbime të veçanta, të cilat mund të tregojnë abuzim ose përdorim të paautorizuar. Përdoruesi duhet të paralajmërohet*

nëse përdorimi është dyfishi i përdorimit mesatar të shërbimit në tre (3) muajt e mëparshëm (përveç rasteve kur mund të përcaktohet ndryshe nga një vendim i marrë nga AKEP)”.

PLUS është i mendimit që kjo dispozitë të hiqet duke konsideruar që aktualisht PLUS vendos një kredit limit për çdo klient sipas llojit të klientit, dhe njofton klientin kur kalon shpenzimin mbi këtë limit, rrjedhimisht duke bërë kontrollin e sjelljes së zakonshme të klientit. Për klientët që kanë më shumë se 6 muaj në PLUS përveç kredit limit analizohet edhe përdorimi mesatar i 2-3 muajve të fundit.

Për shkronjën b) të po kësaj pike, PLUS është i mendimit që të përcaktohet sa herë mund të jepet fatura e detajuar pa pagesë, meqënëse aktualisht fatura e detajuar për shërbimet e ofruara jepet pa pagesë, por nëse kërkohet riprintimi në pikat e shitjes së operatorit ajo të ofrohet kundrejt një pagese.

Pika iii) e shkronjës b), PLUS është i mendimit që kjo pikë të riformulohet si më poshtë *“shërbimet pa pagesë, telefonatat falas (0800) dhe thirrjet drejt numrave të emergjencës nuk do të regjistrohen në faturë”*.

PLUS është i mendimit që shkronja c) të riformulohet duke konsideruar se aktualisht kryhet bllokimi i thirrjeve duke lënë jashtë bllokimit numrat e emergjencës dhe kujdesi ndaj klientit, por nuk është e mundur të përzgjidhen grupe të caktuara numrash brenda atyre me pagesë.

Në pikën iii) të shkronjës c), PLUS sugjeron të ndryshohet si vijon: *“Me kërkesë të pajtimtarit, sipërmarrësi duhet të njoftojë me shkrim pajtimtarin së bashku me faturën dhe të paktën një herë në 6 muaj, mbi të gjitha mundësitë e bllokimit të thirrjeve të disponueshme për ta dhe veçanërisht mundësive të referuar më sipër”*.

PLUS është i mendimit se shkronja d) të hiqet pasi seleksionimi i thirrjeve dalëse ose thirrjet drejt disa numrave ose grup numrash, siç përcaktohet në shkronjën nuk është e mundur.

Në pikën 23.5.2 “Formati dhe Përmbajtja e Faturës së Pajtimtarit”, shkronja b) të përcaktohet qartë cili është formati alternativë.

Gjithashtu PLUS është i mendimit që në shkronjën c) të kësaj pike shprehja *“...detaje të paraqitura qartësisht në lidhje me kushtet dhe afatet kohore për ankesat..”* të hiqet meqënëse në termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit janë të paraqitura qartë mënyra dhe afatet e ankesës në lidhje me faturimin.

PLUS propozon që për zbatimin e kësaj Rregullore të përcaktohet një periudhë tranzitore me qëllim që të mundësojë përshtatjen e sistemeve tona për plotësimin e kushteve të paraqitura nga AKEP.

4.3 - Vodafone Albania sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

- Vodafone Albania sh.a. kërkon që formulimi i pikës 20/3 persa i takon faturës së pajtimtarit ka nevojë të rishikohet për të qënë në përputhje të plotë me aktet e tjera ligjore dhe rregullore që i referohen kësaj çështjeje, konkretisht, ligjit 9918/2008 dhe Rregullores nr.

27 datë 21.09.2012 “Mbi publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”.

- Në pikën 23.5.1.a/i) Vodafone Albania sh.a. ngre shqetësimin për formulimin e dhënë nga rregullatori në këtë çështje. Vodafone Albania sh.a. zbaton standarde transparence dhe mbrojtjeje ndaj pajtimtarit prej disa vitesh për shpenzimet në roaming dhe data (80% konsum te ky i fundit). Ndërkohë që njoftimi paralajmërues i propozuar nga AKEP në formën ‘*në rast kalimi të dyfishit të vlerës mesatare për 3 muajt e fundit*’ kërkon dizenjimin dhe implementimin e një aplikimi shumë kompleks dhe të kushtueshëm në sistemet e faturimit të brendshëm. Duke mbajtur në vëmendje çrregullsinë e sjelljes konsumatore të pajtimtarëve dhe nevojën diskrete të secilit konsumator për ‘*tavan*’ të ndryshëm njoftimi shpenzimesh, Vodafone Albania sh.a. gjykon të arsyeshme që kjo dispozitë të kufizohet në njoftimin përtej konsumit të pa-arsyeshëm, çka i jep mundësi secilit prej sipërmarrësve që të përshtasin rast pas rasti dhe brenda kapaciteteve teknike dhe financiare detyrimin për transparencë dhe mbrojtje.

Për sa më lart, Vodafone Albania sh.a. sugjeron riformulimin në vijim:

Për pikën “23.5.1: Mbrojtja nga mbifaturimi i pajtimtarit në Rrjetin e Komunikimeve Publike Elektronike.

Për pikën 23.5.1.a/i: *Sipërmarrësit duhet të kontrollojnë sjelljen e zakonshme të përdoruesve gjatë përdorimit të shërbimit, dhe t’i njoftojnë ata për ndonjë rritje të pazakontë, te paarsyeshme dhe të papritur të shpenzimeve për shërbime të veçanta, të cilat mund të tregojnë abuzim ose përdorim të paautorizuar”.*

- Në pikën 23.5.1.b/iii) Vodafone Albania sh.a. gjykon si të panevojshme përfshirjen në faturë me kërkesë të pajtimtarit të eventeve pa pagesë, përse kohë ato nuk faturohen. Qëllimi në vetvete i faturës është që të garantojë transparencë faturimi për shërbimet dhe tarifën e tyre, ndërsa në rastin kur thirrjet nuk janë tarifuar atëherë kjo është jo-relevante dhe kërkon një investim të shtuar dhe kompleks në sistem, i cili do të duhej të aplikohet rast pas rasti sipas kërkesës së cdo individit, ndërkohë që sistemet e faturimit përballojnë nevojën për miliona pajtimtarë paralelisht e nuk mund të personalizohen për kërkesa jo-proporcionale e që nuk justifikojnë vlerën e investimit. Nga ana tjetër, çdo pajtimtar gëzon të drejtën e pacënuar që në çdo kohë bazuar në lgjin për ‘Mbrojtjen e të dhenave personale’ të paraqesë një kërkesë të veçantë për tu njohur me çdo të dhënë personale që disponon operatori sipërmarrës brenda një afati të caktuar kohor.

Për sa më lart, Vodafone Albania sh.a. sugjeron riformulimin në vijim:

Për pikën “23.5.1.b/iii): *shërbimet pa pagesë, telefonatat falas (0800) dhe thirrjet drejt numrave të emergjencës nuk do të regjistrohen në faturë”.*

- Në pikën 23.5.1.c/i, ii) Vodafone Albania sh.a. gjykon si të papërshtatshme përshkallëzimin e bllokimit të thirrjeve dalëse deri në nivel grupi thirrjesh pasi kjo kërkon një zgjidhje teknike tejet të detajuar dhe shumë të kushtueshme. Sidoqoftë Vodafone Albania sh.a. mirëkupton bllokimin e thirrjeve për kategori të përgjithshme thirrjesh dalëse, si në rastin e thirrjeve ndërkombëtare në tërësi, roaming në tërësi apo drejt numrave të shkurtër 0900 në tërësi. Vodafone Albania sh.a. garanton që gjithmonë mundëson kryerjen e thirrjeve të emergjencës (sipas detyrimit ligjor) dhe njëkohësisht mbron konsumatorin pasi ofron plane tarifore alternative siç është U-control ku pajtimtari zgjedh një plan me një pagesë ‘tavan’ të caktuar, dhe më pas zgjedh të parapaguajë çdo thirrje/SMS të kryer përtej konsumit të shumës ‘tavan’.
- Nga ana tjetër, informimi i pajtimtarëve në kohe reale për sa i takon shpenzimit të tyre (*pajtimtarët me paspagim*) është realisht dhe praktikisht i pamundur për teknologjinë që sipërmarrësit sot disponojnë pasi është kompleks nga ana e teknologjisë, është shumë i kushtueshëm, nuk arrin të zgjidhë problemin e konsumit në roaming (*informacioni nga operatori i huaj faturuës në roaming vjen vetëm pas disa ditësh*), nuk mund të llogarisë uljet (*discounts*) që mund ti ofrohen pajtimtarëve rast pas rasti në fund të muajit, e kështu me rradhë.

Për sa më lart, Vodafone Albania sh.a. sugjeron riformulimin në vijim:

Për pikën “23.5.1.c: *Sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet t’u lejojnë pajtimtarëve të tyre, që me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, të bllokojnë kryerjen e thirrjeve dalëse kur shpenzimet mujore të këtyre thirrjeve tejkalojnë një nivel të paracaktuar, dhe bllokimin e kryerjes së kategorive të caktuara të thirrjeve dalëse dhe veçanërisht si më poshtë:*

i) *mundësia e bllokimit të thirrjeve dalëse i referohet ekskluzivisht thirrjeve që janë me pagesë, dhe sipërmarrësit duhet të krijojnë mundësinë kryerjes së thirrjeve drejt numrave të emergjencës dhe telefonat pa pagesë të shërbimeve të kujdesit për klientin të operatorit;*

ii) *pajtimtarët që kanë kërkuar bllokimin e thirrjeve dalëse kanë të drejtë të informohen rreth konsumit të tyre në çdo kohë dhe në mënyrë të thjeshtë dhe duhet të informohen nëse përdorimi i shërbimit gjatë një muaji i afrohet madhësisë së paracaktuar për këtë”.*

- Në pikën 23.5.1.c/iii) Vodafone Albania sh.a. gjykon si të papërshtatshme dhe jo-koherente përcaktimin se njoftimi duhet të bëhet vetëm me shkrim në mënyrë shteruese. Ashtu siç edhe përcaktohet në Kontratën e Pajtitimit, mjetet e njoftimit duhet të jenë alternative, ti përgjigjen zhvillimit teknologjik dhe nevojës për reduktim kostosh të paarsyeshme si dhe të mundësojnë komunikimin me adekuat rast pas rasti, ku të perfshihen njoftimi me shkrim, email, SMS apo web.

Për sa më lart, Vodafone Albania sh.a. sugjeron riformulimin në vijim:

Për pikën “23.5.1.c/iii): sipërmarrësit duhet që periodikisht të informojnë gjithë pajtimtarët mbi të gjitha mundësitë e bllokimit të thirrjeve të disponueshme për ta, dhe veçanërisht rreth mundësive të referuar më sipër.”

- Për pikën 23.5.2/b Vodafone Albania sh.a. dëshiron të ngrejë shqetësimin para AKEP se pavarësisht vullnetit tone të kahershëm për të ndërmarre inisiativa pro-aktive në këtë drejtim, e kemi patur të pamundur të gjejmë dhe kontraktojmë ofrues shërbimesh që sigurojnë dhe furnizojnë faturën dhe kontratën në formatin e nevojshem alternativ për të plotësuar nevojat e njerëzve me probleme shikimi. Vodafone Albania sh.a. mbetet e gatshme që sapo kushtet dhe rrethanat në tregun shqiptar ta mundësojnë, të marre masa konkrete dhe të investojë për të mundësuar këtë facilitet për grupin e personave në fjalë.

Për sa më lart, Vodafone Albania sh.a. sugjeron riformulimin në vijim:

Për pikën “23.5.2/b: Me kërkesë të pajtimtarit dhe kur kjo është e mundur, fatura duhet të jetë e disponueshme në një format alternativ të për të plotësuar nevojat e njerëzve me probleme shikimi.”

- Për pikën 23.5.2./c Vodafone Albania sh.a. shprehet se është e paarsyeshme dhe e panevojshme që të parashikohen në faturë kushtet dhe afatet kohore për ankesat. Konkretisht, të gjithë keto elemente janë qartësisht të parashikuar dhe përfshirë në Kushtet e Përgjithshme të Ofrimit të Shërbimit (Kontrata e Pajtimtarit, Aneksi 2) dhe për rrjedhojë janë të disponueshme dhe lirisht të aksesueshme për pajtimtarët nëpërmjet një morie formash të komunikimit masiv, përfshirë faqen zyrtare të internetit të Vodafone Albania sh.a. dhe fletëpalosjet në dyqanet Vodafone. Nga ana tjetër, sqarojmë së elementet që duhet të përmbajë fatura për shërbimet e komunikimeve elektronike janë të parashikuara në nenet 106 dhe 40 përkatësisht të Ligjeve Nr. 9918 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Nr.9902 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve” i ndryshuar.

4.4 - Albanian Mobile Communication sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

- **Në Pikën 23.5.1 për gjermën a/i:**

Në këtë pikë duhet të merret parasysh situata kur abonenti është në roaming dhe në këtë rast sipërmarrësi pret të informohet nga partneri roaming për trafikun e realizuar nga abonenti. Ka situata në të cilat informacioni nuk vjen në kohë për shkaqe të ndryshme të problemeve me sistemet e billingut të partnereve të roamingut apo të lidhjeve fizike. Këto raste janë të parashikuara me kontratat dhe rregulloret e GSMA. Prandaj kerkojme te shtohet “përjashtimi i trafikut roaming”.

Një problem tjetër për AMC është kur kredit limiti i vendour nga kompania është më i lartë se vlera e parashikuar në këtë pikë. Kështu ne propozojmë që të shtohet paragrafi: “Përjashtim bën gjithashtu rasti kur edhe pse trafiku i klientit është më shumë se 2 fishi i

mesatares se 3 muajve të fundit, kredit limiti i vendosur për këtë numër është më i lartë se ky trafik, strukturat përkatëse që bëjnë njoftimet në kompani nuk e njoftojnë derisa ky klient të kalojë edhe kredit limitin.”

- **Në Pikën 23.5.1 për gjermën b/iii:**

Për këtë pikë AMC shprehet se nuk kuptohet se perse kërkohet ky ndryshim dhe ç'vlere ka. Në lidhje me këtë pikë kjo kërkesë kërkon ndryshimet e sistemeve të faturimit, i cili në pikëpamjen e AMC nuk sjell asnjë vlerë tek pajtimtari, përveç se komplikon proceset e e sipërmarrësve dhe rrit kostot e tyre.

AMC propozon që kjo pikë të hiqet.

- **Në gjermën c për pikën i) dhe pikën ii):**

Kërkesat e parashuar në keto dy pika do të gjenerojnë ndryshimin e sistemeve si dhe një volum pune të jashtëzakonshëm nga ana e sipërmarrësve të cilët duhet të ekzekutojnë shumë procese të cilat në fund të fundit përveçse do të rrisin koston e tyre të operacioneve do të krijojnë edhe problematika me pajtimtarët sepse situatat do të jenë nga me të ndryshmet: pajtimtarët një herë do të kerkojnë te bllokohen, një herë tjetër të hapen e kështu me radhë. Për më tepër ofrimi i këtij shërbimi pa pagesë do të rrisë kërkesat abuzive.

AMC propozon që ky shërbim të mos aplikohet. Pajtimtari e ka vetë ne dorë të kryejë thirrje apo të mos kryejë thirrje drejt disa numrave.

- **Në gjermën c për pikën ii):**

AMC shprehet se kjo pikë është e paqartë. Ç'nënkuptohet të njoftimi me shkrim dhe në mënyrë periodike mbi mundësinë e bllokimit të thirrjeve të disponueshme për ta?

Shërbimet e telekomunikacioneve janë që të krijohet mundësia për thirrje nga të gjitha drejtimet. Ky lloj njoftim do të krijojë edhe më shumë konfuzion tek pajtimtarët. Aq më tepër nëse dërgohet në mënyrë periodike.

AMC kërkon që të mos aplikohet kjo kërkesë.

- **Për gjermën e:**

Afati kohor i lënë këtu për këtë paragraf është i pamjaftueshëm. Këto ndryshime të kerkuara do të kërkojnë ndryshime të sistemeve të faturimit dhe të kujdesit ndaj klientit të cilat kërkojnë investime shtesë dhe kohë të mjaftueshme për implementim.

AMC propozon që kjo të jete në një afat të paktën 1 vit e gjysëm.

4.5 - Qëndrimi i AKEP:

Mbi komentet e sipërmarrësve në lidhje me Pikën 23/5 “Fatura e Pajtimtarit”.

- Qëndrimi mbi komentet për pikën 23.5.1 “Mbrojtja ndaj Abuzimit dhe Mashtrimit në Rrjetin e Komunikimeve Publike Elektronike”.
- Qëndrimi mbi komentet për pikën 23.5.2 “Formati dhe përmbajtja e faturës së pajtimtarit”.

AKEP gjykon se përcaktimet e pikave 23.5.1 dhe 23.5.2 të aneksit C të dokumentit rregullator “Mbi ndryshimet dhe shtesat në Rregulloren e Autorizimit të Përgjithshëm”, plotësojnë kuadrin ligjor dhe nën-ligjor për qartësim të detyrimeve të sipërmarrësit për mbrojtjen e përdoruesve nga abuzime të mundshme si dhe për detaje shtesë për faturat e lëshura nga sipërmarrësi. Detajet shtesë për faturat nuk janë në kundërshtim me nenin 106 të Ligjit 9918, pasi neni përcakton detajet minimale të faturës, si dhe janë informacion krejt normal që duhet të përmbajë një faturë:

- afati i pagesës;
- metoda e pranueshme e pagesës;
- detaje të kontaktimit të kujdesit të klientit për çdo paqartësi;
- informacion se kur dhe si mund të ankohe për faturën.

Këto detaje aktualisht janë të përfshira në faturat e shumë sipërmarrësve, dhe nuk përbëjnë barrë të rëndë për sipërmarrësin.

Në lidhje me përcaktimet në 23.5.1, AKEP gjykon se të gjitha këto i shërbejnë mbrojtjes më të mirë të konsumatorit, pasi në shërbimet e komunikimeve elektronike mund të ndodhin raste abuzimesh duke rezultuar në fatura shumë të larta padrejtësisht për pajtimtarin. Masat që duhet të ndërmerren sipërmarrësi janë jo vetëm për mbrojtjen e konsumatorit (pajtimtarit) por edhe për të shmangur mos-marrveshjet e mundshme që mund të lindin për pagesën e faturave si dhe borxhet e këqija që mund të krijohen nga këto raste në dëm të sipërmarrësit.

Gjithsesi AKEP ka marrë në konsideratë pjesërisht komentet e bëra nga sipërmarrësit në lidhje me pikat 23.5.1 dhe 23.5.2 duke bërë disa ndryshime. Ndryshimet nga propozimet e bëra në këshillim publik konsistojnë midis të tjerave në:

- ndryshim të titullit të pikës 23.5.1;
- ndryshim të pikës 23.5.1/i ;
- shtimin e pikës (iii) në pikën 23.5.1, e cila plotëson detyrimet në lidhje me aksesin në Internet kur paketa e blerë është me kufizim në ‘doenload’, si për rrjetet fikse dhe celulare (detyrimi i pikës (iii) të shtuar është aktualisht pjesë e kontratave të pajtimtarit për aksesin në Internet në rrjete fikse).

- ndryshim në pikën 23.5.1/b/iii, për përfshirje të thirrjeve drejt numrave pa pagesë vetëm në rastet kur për muaj të caktuar pajtimatri kërkon faturë më të detajuar, pra plotësim kërkesë rast pas rasti.
- ndryshime në pikën 23.5.1/b për të qartësuar se:
 - o **bllokim të disa lloje thirrjesh dalëse ose thirrjet drejt disa numrave ose grup numrash**, i referohen kryesisht rasteve të tilla si thirrje drejt numrave me vlerë të shtuar, thirrje ndërkombëtare, thirrje në roaming ndërkombëtar, që kanë kosto të lartë dhe që lëhtësisht mund të seleksionohen nga sipërmarrësi.
 - o Informim në cdo kohë dhe në mënyrë të thjeshtë për shpenzimet, nuk nënkupton informim në kohë reale por me kërkesë të pajtimtarit, ndërsa kur shpenzimet i afrohen nivelit të paracaktuar, sipërmarrësi duhet të paralajmërojë pajtimtarin;
 - o Informimi me shkrim përfshin edhe SMS, email.
- heqjen e pikës 23.5.1/e.
- ndryshim të pikës 23.5.2/b, për shkak të vështirësive në Shqipëri për printime për personat me aftësi të kufizuara shikimi;
- ndryshim në pikën 23.5.2/c, për përfshirje në kontratë të afatit të kryerjes së ankesave nga pajtimtari, ndërsa informacioni më i detajuar për ankesat dhe procedurat e mosmarrësveshjeve duhet të jnë pjesë e kontratës si dhe ky informacion të ofrohet nga kujdesi i klientit, numri i të cilit duhet të jetë në faturë.

- AKEP, pas marrjes në konsideratë të komenteve të Albtelecom sh.a., Plus Communication sh.a., Vodafone Albania sh.a dhe AMC sh.a., ka bërë ndryshimet e mëposhtëme në pikën 23.5.1 dhe pikën 23.5.2:

4.5.1 - Ndryshimet në pikën 23.5.1 - Mbrojtja nga mbifaturimi i pajtimtarit në Rrjetin e Komunikimeve Publike Elektronike.

- Tek pika 23.5.1 është riformuluar titulli:

Mbrojtja nga mbifaturimi i pajtimtarit në Rrjetin e Komunikimeve Publike Elektronike.

- Pika 23.5.1, gërma a/i ndryshohet dhe bëhet me përmbajtje si më poshtë:

Sipërmarrësit duhet të kontrollojnë sjelljen e zakonshme të përdoruesve gjatë përdorimit të shërbimit, dhe t'i njoftojnë ata për ndonjë rritje të pazakontë, të paarsyeshme dhe të papritur të shpenzimeve për shërbime të veçanta, të cilat mund të tregojnë abuzim ose përdorim të paautorizuar.

- Tek pika 23.5.1.a pas pikës ii) shtohet pika iii) me përmbajtje si më poshtë:

iii) Pajtimtari i Aksesit në Internet duhet veçanërisht të njoftohet me mjete elektronike (si p.sh. SMS, mesazh në PC, telefon) kur arrihet niveli 80% i kufizimit “doëload’/’upload” (nëse ka të tillë). Sipërmarrësi mund të kufizojë shpejtësinë e Aksesit në Internet pas kalimit të kufizimit doëload/upload, për të reduktuar mundësinë e shpenzimeve shumë të larta për pajtimtarin pas tejkalimit të kuotës/limitit.

- Pika 23.5.1, gërma b/iii) ndryshohet dhe bëhet me përmbajtje si më poshtë:

shërbimet pa pagesë si telefonatat falas (0800) dhe thirrjet drejt numrave të emergjencës nuk do të regjistrohen në faturë, përveç se në rastet kur kërkohet nga pajtimtari faturë më e detajuar, rast pas rasti.

- Pika 23.5.1.c) ndryshohet dhe bëhet me përmbajtje si më poshtë:

Sipërmarrësit e ofrimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet t’u lejojnë pajtimtarëve të tyre, që me kërkesën e tyre dhe pa pagesë, të bllokojnë kryerjen e thirrjeve dalëse kur shpenzimet mujore të këtyre thirrjeve tejkalojnë një nivel të paracaktuar, dhe bllokimin e kryerjes së thirrjeve drejt kategorive të caktuara numrash, dhe veçanërisht si më poshtë:

- Ne piken 23.5.1.c), pika i), pika ii) dhe pika iii) ndryshojnë dhe bëhen me përmbajtje si më poshtë:
- *i) mundësia e bllokimit të thirrjeve dalëse i referohet ekskluzivisht thirrjeve që janë me pagesë si, drejt numrave të shërbimeve me vlerë të shtuar, thirrje ndërkombëtare, roaming ndërkombëtar, dhe sipërmarrësit duhet të krijojnë mundësinë kryerjes së thirrjeve drejt numrave të emergjencës dhe telefonat pa pagesë të shërbimeve të kujdesit për klientin të operatorit;*
- *ii) pajtimtarët që kanë kërkuar bllokimin e thirrje dalëse kur shpenzimet e tyre mujore kanë tejkaluar nivelin e paracaktuar kanë të drejtë të marrin informacion rreth konsumit të tyre në çdo kohë dhe në mënyrë të thjeshtë, dhe duhet të informohen nëse përdorimi i shërbimit gjatë një muaji i afrohet madhësisë së paracaktuar për këtë;*
- *iii) operatorët duhet që periodikisht (të paktën një herë në vit) të informojnë me shkrim (si komunikim me SMS, e-mail, përfshirje në faturën e një muaji) gjithë pajtimtarët mbi të gjitha mundësitë e bllokimit të thirrjeve të disponueshme për ta, dhe veçanërisht rreth mundësive referuar këtij Neni.*
- Pika 23.5.1.e) hiqet

4.5.2 – Ndryshime në pikën 23.5.2 Formatit dhe Përmbajtja e Faturës së Pajtimtarit.

- Pika 23.5.2.b) ndryshohet dhe bëhet me përmbajtje si më poshtë:

b) Me kërkesë të pajtimitarit, përmbajtja e faturës mund të jetë e disponueshme dhe në mënyrë alternative për të plotësuar nevojat e njerëzve me probleme shikimi.

- Pika 23.5.2.c) ndryshohet dhe bëhet me përmbajtje si më poshtë:

c) Çdo faturë e pajtimitarit do të përfshijë në mënyrë të qartë afatin e pagesës së faturës, si edhe metodat e pranueshme të pagesës, afatet kohorë për ankesat si edhe detajet e kontaktimit të shërbimit të kujdesit për klientin.

5 - Komente të sipërmarrësve mbi pagesat e propozuara në pikën 33.2 “Pagesat për kostot administrative të aplikimeve online”:

5.1 - Albtelecom sh.a.

Në komentet e tij parashtrohet si më poshtë vijon:

Aktualisht, pagesat që kryhen nga sipërmarrësit në AKEP rregullohen sipas neneve 24, 78, 86, 117 dhe 119 të Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në pikën 4 të Nenit 119 **Pagesat**, përcaktohet ndër të tjera se kostot administrative të AKEP mbulohen nga pagesat për mbikëqyrjen e tregut, pagesat për numeracionin dhe ato për frekuencat.

Në nenin 24 të ligjit Nr.9918 **Pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike**, përcaktohet se kostot administrative të AKEP mbulohen nga pagesa vjetore për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike nga AKEP-i.

Gjithashtu, në Rregulloren “Mbi pagesat për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike” miratuar me VKD të AKEP, Nr.1170, datë 19/02/2010 përcaktohet se “Qëllimi i rregullores është që me anë të pagesës vjetore për mbikëqyrjen e tregut, sipas nivelit të llogaritur mbi bazën e kësaj rregulloreje, si dhe pagesat e tjera që kryhen sipas neneve 78 dhe 86 të ligjit nr. 9918, të garantohet financimi i nevojshëm për mbulimin e fondit të shpenzimeve administrative të AKEP, në përputhje me nenin 117 të këtij ligji”.

Albtelecom është i mendimit që kjo pagesë nuk gjen vënd për tu aplikuar pasi legjislacioni në fuqi mbi pagesat që kryhen në AKEP parashikon të gjitha llojet e pagesave që mundësojnë rikuperimin e kostove administrative që i shkaktohen AKEP gjatë kryerjes së aktivitetit të tij. Ndaj, Albtelecom sugjeron që Rregullorja për Autorizimin e Përgjithshëm të mos amendohet në lidhje me kryerjen e pagesave shtesë për AKEP.

5.2 - Albanian Mobile Communication sh.a.

Në komentet e tij parashtron si më poshtë vijon:

- AMC nuk është dakort në lidhje me propozimin e AKEP për shtimin e pikës 33.2 në lidhje me pagesat për kostot administrative të aplikimeve online, pasi AKEP nuk ka bërë publike kostot administrative, në bazë të të cilave duhet të kryhen pagesat përkatëse nga ana e operatorëve për aplikimet online.
Këto pagesa për çdo lloj aplikimi apo ndryshim të dhënash në aplikimet online janë të pajustificuara se mbi cilat kosto bazohen, kur AKEP nuk ka llogaritur se cilat janë këto kosto në lidhje me implementimin dhe vënien në përdorim të sistemit të aplikimeve online, në mënyrë që të justifikojë pagesat të cilat propozohen në këtë dokument, pasi do të përbëjnë një kosto shtesë për operatorët për çdo aplikim që ata bëjnë.
- Sistemi i aplikimit online është implementuar për të bërë sa më eficient dhe të shpejtë në kohë sistemin e raportimeve dhe komunikimit ndërmjet AKEP dhe operatorëve, dhe jo të jetë një barrë financiare për operatorët, pasi dihet që numri i aplikimeve për shërbimet që kryejnë operatorët është i lartë dhe një pagese e tillë për çdo ndryshim ose shtim të dhënash dhe shërbimesh është i pajustificuar duke rritur në këtë mënyrë kostot e operatorëve.

5.3 - Qëndrimi i AKEP:

AKEP, në lidhje me pagesat e sipërpërmendura nga sipërmarrësit Albtelecom sh.a dhe AMC në nenet 24, 78, 86, 117 dhe 119 të Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “*Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, ku janë të përcaktuara sipas rastit pagesat për mbikëqyrjen e tregut, për numeracionin dhe ato për frekuencat, sqaron se në këto pagesa përfshihen përveç të tjerave dhe pagesat për kostot apo shpenzimet administrative, **të cilat administrohen nga AKEP për proceset pas regjistrimit të sipërmarrësve për rrjete dhe/ose shërbime publike të komunikimeve elektronike.**

- Pagesat e propozuara në pikën 33.2 “Pagesat për kostot administrative të aplikimeve online”, do të justifikojnë kostot apo shpenzimet administrative të AKEP në **menaxhimin e procesit të aplikimeve online të sipërmarrësve për vlerësimin e njoftimit për regjistrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe pajisjes me Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit.**
- Për saktësim dhe kuptim më të qartë, gërma a dhe gërma b e pikës 33.2 “*Pagesat për kostot administrative të aplikimeve online*”, riformulohen si më poshtë vijon:

gërma a)

Sipërmarrësit të cilët aplikojnë online për herë të parë, duke dërguar njoftimin e regjistrimit të ofrimit të rrjeteve dhe shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, për të cilët AKEP lëshon Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, duhet të kryejnë pagesën në vlerën 10.000 lekë. Kjo pagesë kryhet vetëm një herë.

gërma b)

Sipërmarrësit e regjistruar në AKEP, të cilët dërgojnë njoftim për ndryshimin e të dhënave ligjore dhe shtim ose heqje të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, ndryshime për të cilat AKEP lëshon Certifikatën e Konfirmimit të Njoftimit, duhet të kryejnë për çdo rast pagesën në vlerën 5.000 lekë.

III – Për plotësimin e Certifikatës së Konfirmimit të Njoftimit me elementin Bar Code / QR_Code).

1. AKEP, ka vlerësuar kryesisht, me qëllim identifikimin e dokumentit të lëshuar “*Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit*” sipas modelit të Aneksit B të Rregullores, të shtohet në nenin 4 të Kreut të II-të “*Procedurat dhe kushtet e Autorizimit të Përgjithshëm*”, pika 4 me përmbajtjen si më poshtë vijon:

Pika 4 – *Çertifikata e Konfirmimit të Njoftimit, do të përmbajë elementin Bar Code / QR_Code.*

